

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

UNMIK/DIR/2000/20
19 dhjetor 2000

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2000/20

**NDRYSHIMI I URDHËRESËS ADMINISTRATIVE NR. 2000/2 PËR ZBATIMIN E
RREGULLORES SË UNMIKUT NR. 2000/3 MBI TATIMIN NË QARKULLIM NË
KOSOVË TË DATËS 22 JANAR 2000**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rregulloren nr. 2000/3 të Misionit të
Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK) mbi Tatimin në qarkullim në Kosovë,

Pas shpalljes së Urdhëresës administrative nr. 2000/2 për zbatimin e Rregullores nr. 2000/3,

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të efikasitetit të tatimit në qarkullim në Kosovë,

Nëpërmjet të kësaj Urdhërese ndryshon nenin 1 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut
nr. 2000/2,

Rrjedhimisht, Urdhëresa administrative do të ketë formulimin e mëposhtëm duke filluar nga
dita kur kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi:

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2000/02

**ZBATIMI I RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2000/2 TË 22 JANARIT 2000 MBI
TATIMIN NË QARKULLIM NË KOSOVË**

Perfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/3 mbi
Tatimin në Qarkullim në Kosovë të datës 22 janar 2000,

Shpall Urdhëresën administrative vijuese:

Neni 1
Përrjashtimet

1.1. Tatimi në qarkullim nuk do të paguhet për mallrat vijuese:

- (a) Për kategoritë e mallrave të shënuara në Aneksin A të kësaj Urdhërese administrative;
- (b) Për mallrat që eksportohen e që i nënshtrohen dëshmisë së eksportit në pajtim me procedurat e lejuara nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut;
- (c) Për mallrat për të cilat drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut vendos se duhet të përdorën vetëm për qëllime humanitare dhe të cilat nuk ofrohen për shitje në Kosovë dhe
- (ç) Mallrat e tjera të tilla, të cilat i saktëson Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me anë të urdhëresës administrative, në varësi të kushteve të cilat ai i konsideron adekuate.

1.2. Tatimin në qarkullim nuk do të paguajnë:

- (a) Misionet e huaja diplomatike dhe konsulare;
- (b) Kombet e Bashkuara, ose cilido organ i tyre, duke përfshirë UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe agjencitë qeveritare në mallrat e përdorura për qëllime zyrtare;
- (c) Kontraktuesit e UNMIK-ut, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe KFOR-i, të cilët importojnë mallra për t'u përdorur vetëm nga ata kontraktues lidhur me përmbushjen e kontratave për UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara ose për KFOR-in.
- (ç) Organizatat joqeveritare të regjistruara me status të privilegjuar publik, siç është përkufizuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/22 të datës 15 nëntor 1999 nëse mallrat përdoren vetëm nga organizata joqeveritare për përmbushjen e qëllimeve të interesit publik. Sidoqoftë, ky përjashtim nga tatimi në qarkullim nuk do të vlejë për alkool, etanol, pijet alkoolike, verërat e pasuruara, verërat, birrën, pijet joalkoolike, kafënë, cigaret, cigaret puro, cigarillosin dhe prodhimet e tjera të përpunuara të duhanit dhe
- (d) Organizatat tjera të tilla apo entitetet të cilat Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i liron nga pagesa e këtij tatimi me urdhëresë administrative sipas kushteve të cilat ai i konsideron të arsyeshme.

Neni 2
Mbledhja

Si masë e përkohshme, tatimi në shitje do të vlerësohet, vilet dhe mbledhet si vijon:

- (a) Për mallrat e importuara: në vendkalimet e autorizuarra kufitare ndërkombëtare dhe në depot e brendshme të zhdoganimit;
- (b) Për mallrat e tjera që hyjnë në Kosovë: në zyrat e mbledhjes së tatimqarkullimit dhe
- (c) Për mallrat e prodhuara në Kosovë: mbledhja e tatimit në qarkullim do të pezullohet deri në njoftimin tjetër.

Neni 3
Procedurat dhe kundërvajtjet

Urdhëresat mbi procedurat e tatimit në qarkullim dhe kundërvajtjet do të nxirren në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative¹ hyn në fuqi më 22 janar 2000.

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 21 gusht 2000.

Bernard Kouchner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm
(*Nënshkrimi*)

¹ Urdhëresa e parë administrative

ANEKSI A
KATEGORITË E MALLËRAVE QË NUK I NËNSHTROHEN
TATIMIT NË QARKULLIM

1. Prodhimet farmaceutike
2. Instrumentet mjekësore, kirurgjike dhe pajisjet
3. Qumështi
4. Vaji dhe yndyrërat
5. Perimet
6. Frutat
7. Miell i grurit